



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 gusht 2015
Nr. ref.: RK 834/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI24/15

Parashtrues

Enver Basholli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, GSP-KPA-A-158/13, të 19 marsit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Enver Basholli nga Samadrexha, komuna e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin (GSP-KPA-A-158/13, të 19 marsit 2014) e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), i cili i është dorëzuar atij më 3 nëntor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet t'i jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 mars 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 prill 2015, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 12 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ua dërgoi nga një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit dhe Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP).
8. Më 1 korrik 2015, Kryetarja caktoi veten anëtare të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, mandati i të cilit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka përfunduar më 26 qershor 2015.
9. Më 8 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e aprovoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Banesa në Prishtinë, në pronësi të NSH „Elektrokosova“, është uzurpuar që nga viti 1986 nga punëtorja (në tekstin e mëtejme: punëtorja e parë) e NSH „Elektrokosova“.

11. Më 23 nëntor 1990, punëtores së parë i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës me NSH "Elektrokosova" dhe, rrjedhimisht, banesa ishte liruuar.
12. Më 28 nëntor 1993, NSH "Elektrokosova" ia ndau banesën për shfrytëzim një punëtori tjetër (në tekstin e mëtejme: punëtori i dytë).
13. Më 18 mars 1994, punëtori i dytë u bë pronar i banesës në bazë të kontratës së shitblerjes, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
14. Në një datë të pacaktuar, punëtorja e parë paraqiti kërkesë në Komisionin për Kërkesa Pronësore Banesore (në tekstin mëtejme: KKPb) për vërtetimin e të drejtave të pronësisë së banesës.
15. Më 13 maj 2004, parashtruesi i kërkesës përfundimisht bleu banesën nga punëtori i dytë, me kontratën e shitblerjes OV. nr. 2616/2004, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
16. Më 22 tetor 2005, KKPb-ja (Vendimi HPCC/D/226/2005/A&C), aprovoi kërkesën e punëtores së parë, duke ia njohur të drejtën e banimit që e kishte humbur "*si pasojë e diskriminimit gjatë periudhës prej 23 marsit 1989 deri më 24 mars 1999*".
17. Vendimi i KKPb-së ishte nxjerrë si një vendim grupor lidhur me disa kërkesa, ku, *inter alia*, kërkesa e punëtores së parë ishte kontestuar nga punëtori i dytë, ndërsa kërkesa e punëtorit të dytë ishte kontestuar nga punëtorja e parë. Të dyja kërkesat kishin të bënin me banesën në fjalë. Kërkesa e punëtores së parë ishte pranuar si e bazuar, ndërsa kërkesa e punëtorit të dytë ishte refuzuar.
18. Për më tepër, KKPb-ja vendosi që kontrata e shitblerjes Ov. nr. 2616/2004, e 13 majit 2004, e lidhur ndërmjet punëtorit të dytë dhe parashtruesit të kërkesës "*ishte në kundërshtim me nenet 5.1 dhe 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, prandaj edhe ajo edhe ishte e pavlefshme*".
19. Më 19 dhjetor 2005, punëtori i dytë dhe parashtruesi i kërkesës parashtruan kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit HPCC/D/226/2005/A&C. Punëtorja e parë ishte palë e kundërshtuar në këtë procedurë.
20. Më 31 mars 2006, kërkesa për rishqyrtim u hodh poshtë si e pabazuar, sepse "*Palët kërkuese nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi të re relevante ligjore e cila nuk është shqyrtuar nga Komisioni gjatë vendosjes së kërkesave. Gjithashtu Komisioni nuk ka gjetur ndonjë gabim material në aplikimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/60*".
21. Më 29 gusht 2007, parashtruesi kërkoi nga AKP-ja konfirmimin e të drejtës së tij pronësore mbi të njëjtën banesë, duke theksuar prapë punëtoren e parë si palë të kundërt. Punëtorja e parë parashtroi ankesë në Komisionin për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK).
22. Më 22 tetor 2012, KKPK (Vendimi KPCC/D/R/175/2012) hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit me arsyetimin se kjo çështje ligjore është *res judicata*,

siç ishte vendosur përfundimisht me Vendimin e KKPB-së (HPCC/REC/61/2006), të 31 marsit 2006.

23. Më 27 maj 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër atij vendimi të KKPK-së.
24. Më 19 mars 2014, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi GSP-KPA-A-158/13) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Vendimin e KKPK (Vendimi KPCC/D/R/175/2012), të 22 tetorit 2012.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pohon se procedurat në KKPB dhe në KKPK kanë shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
26. Parashtruesi pretendon se *“gjykata në rrugë gjyqësore ka miratuar procesin administrativ me të cilën ankuesit i është mohuar e drejta e pronësisë të pronës, neni 46 i Kushtetutës. Kjo sepse Gjykata ka pranuar vlerësimet e organit administrativ për gjetjen se puna juridike e konstituimit të së drejtës së pronësisë ishte marr në kundërshtim me rregullat e organit administrativ”*.
27. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon se *“mohimi i të drejtës për të marrë nga gjykata një përgjigje ligjore përfundimtare, përmban cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor të parashikuar me nenin 31 “... dhe cenon të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës.*

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
29. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës.
30. Neni 48 i Ligjit parasheh:
“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
31. Përveç kësaj, rregulli 36 i Rregullores së punës parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse [...] (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, për mbrojtje të pronës dhe për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të garantuara me Kushtetutë.
33. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se KKPb-ja dhe KKPK-ja, si organe administrative, kanë vendosur në mënyrë arbitrare për të drejtën e tij pronësore dhe se *“gjykata ka pranuar vlerësimet e organit administrativ”.*
34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë arsyetim procedural ose material në kërkesën e tij, se ai vetëm thekson pretendimet e lartpërmendura, pa shpjegime të mëtejshme rreth asaj se si dhe pse ndodhën shkeljet e pretenduara.
35. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se Vendimi HPCC/D/226/2005/A&C është i arsyetuar si në aspektin e njohjes së të drejtave të punëtores së parë, po ashtu edhe sa i përket kontratës së shitblerjes ndërmjet punëtorit të dytë dhe parashtruesit të kërkesës *“e cila ishte në kundërshtim me nenet 5.1 dhe 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, prandaj edhe ajo ishte e pavlefshme”.*
36. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit si të pabazuar dhe arsyetoi se:

“Pasi që vendimi i DÇPB-se i datës 22 tetor 2005, ishte konfirmuar me vendimin HPCC/ REC/61/2006 të datës 31 mars 2006, vendimi i DÇPB-së është bërë i plotfuqishëm (...), dhe, rrjedhimisht “nuk lejohet gjykim i ri ndërmjet palëve të njëjta për një çështje ligjore për të cilën ekziston vendimi i plotfuqishëm”. (...) “Pasi që lënda para DÇPB-së kishte të bënte me të njëjtën çështje -banesën, dhe pasi që ajo ishte ndërmjet palëve të njëjta, çështja është res judicata”.
37. Kolegji i Ankesave më tej arsyetoi se *“në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike”.*
38. Gjykata konsideron se procedurat në KKPb dhe KKPK, si dhe në Kolegjin e Apelit ishin të drejta dhe se vendimet ishin tërësisht të justifikuara dhe të arsyetuara plotësisht, përkatësisht shpjegojnë pse *“nuk lejohet gjykim i ri ndërmjet palëve të njëjta për një çështje ligjore për të cilën ekziston vendimi i plotfuqishëm”.*
39. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstaton se procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesit i është ofruar gjykim i drejtë. (Shih, *inter alia*, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Ap. Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut i 10 korrikut 1991; dhe, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, nr. 17064/06, Vendim i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).

40. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar si dhe pse vendimi me të cilin është hedhur poshtë kërkesa e tij për përsëritje të procedurës, në bazë të ekzistencës së *res judicata*, përbën shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale.
41. Në të vërtetë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie*, e cila do të theksonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë (Shih *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si nenet e Kushtetutës, të cilëve u referohet, mbështesin pretendimin e tij, ashtu siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.
42. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese përsërit se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt për sa i përket vendimeve të gjykatave të rregullta, apo autoriteteve të tjera publike. Është detyrë e gjykatave të rregullta ose e autoriteteve të tjera publike t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktvendim i 21 janarit 1999 para. 28; shih, gjithashtu, Rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI70/11, *Parashtrues Faik Hima, Magbule Hima, dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
43. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka dëshmuar dhe nuk ka vërtetuar pretendimin për shkelje të të drejtës së tij për barazi para ligjit, të së drejtës për gjykim të drejtë dhe për mbrojtjen e pronës.
44. Si përmbledhje, Gjykata gjen se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara dhe prandaj kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi